



This programme is funded  
by the European Union



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



# Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Tiranë

2017

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

#### **Autorët**

Megi Llubani  
Esmeralda Hoxha  
Albana Konci  
Ines Leskaj

## Tabela e përmbajtjes

<b>SHKURTIME .....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>7</b>
<b>TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKINË TIRANË .....</b>	<b>9</b>
<b>MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020.....</b>	<b>12</b>
<b>GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT TË STRATEGJISË NË BASHKINË E TIRANËS .....</b>	<b>12</b>
<b>TË DHËNA STATISTIKORE .....</b>	<b>13</b>
<b>REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017.....</b>	<b>15</b>
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	15
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE. ....	17
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA. ....	22
<b>REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË TIRANË .....</b>	<b>23</b>
<b>ANEKSE.....</b>	<b>24</b>
ANEKSI 1- DETYRAT E KOORDINATORIT PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE .....	24
ANEKSI 2- DETYRAT E TË GJITHË ANËTARËVE QË KANË NËSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT SI PJESTARË TË MEKANIZMIT TË RREFERIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE .....	25

## Shkurtime

<b>ASPA</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BGj</b>	Barazia Gjinore
<b>DhBGj</b>	Dhunë me bazë Gjinore
<b>DhF</b>	Dhunë në Familje
<b>DhKG</b>	Dhunë ndaj Grave
<b>GTN</b>	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave në Shqipëri
<b>IZhA</b>	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
<b>KONVENTA CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>KONVENTA E STAMBOLLIT</b>	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>KD</b>	Komiteti Drejtues
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MKR</b>	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
<b>MRR</b>	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
<b>(MMSR)MShMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>NBGj</b>	Nëpunës i Barazisë Gjinore
<b>NjVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>OJF</b>	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
<b>OShC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>OSCE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PKV</b>	Plani Kombëtar i Veprimit
<b>PShSh</b>	Policia e Shtetit Shqiptar
<b>QAGjZh</b>	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
<b>QZhK “Sot për të Ardhmen”</b>	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
<b>REVALB</b>	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
<b>RrFGSh</b>	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
<b>SKBGj</b>	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
<b>ShGPS</b>	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
<b>UM</b>	Urdhër Mbrojtjeje
<b>UMM</b>	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>UN WOMEN</b>	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## Hyrje

**Projekti** “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kunder dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë”, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përvec manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

### ***Rreth organizatave zbatuese***

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për bashkinë e Tiranës raporti u hartua nga Megi Llubani, Esmeralda Hoxha dhe Ines Leskaj. Monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të referimit u krye nga të njëjtat eksperte.

### ***Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?***

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

## **Metodologjia**

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjodhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
  - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
  - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.

- Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikatat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën [WWW.revalb.org](http://WWW.revalb.org)

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.




## Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë Tiranë

Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Tirana është bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje.

**Figure 1. Harta Administrative e Bashkisë Tiranë**



Burimi: UNDP STAR 2

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash

katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit është 502 banorë/ km<sup>2</sup> ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 682 banorë km<sup>2</sup>.

**Tabela 1: Profili i Bashkisë Tiranë**

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Tiranë	Qyteti Tiranë	<b>Tiranë</b>	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11
		<b>Petrelë</b>	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë
		<b>Farkë</b>	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë
		<b>Dajt</b>	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth
		<b>Zall-Bastar</b>	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesem, Bastar – Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i vogel, Selitë Mali
		<b>Bërzhitë</b>	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Klllojkë, Pashkashesh, Lugë- Shalqizë, Rozaverë
		<b>Krrabë</b>	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë
		<b>Baldushk</b>	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i sipërm
		<b>Shëngjergj</b>	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje
		<b>Vaqarr</b>	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë
		<b>Kashar</b>	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek

	<b>Pezë</b>	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë
	<b>Ndroq</b>	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik
	<b>Zall-Herr</b>	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh

**Burimi:Reporter.al**

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Sektori i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Tiranë për vitin 2017 ka lëvruar si ndihmë ekonomike për 5,086 përfitues dhe po sipas të njëjtit burim, popullsia e Tiranës për vitin 2017 numëron 786,863 banorë.

**Tabela 1. Të dhëna mbi përfituesit e Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Tiranë viti 2017**

Nr.	Njesia administrative	Nr përfituesish nga vendimi	Vlera nga vendimi
1	Njesia nr 1	232	855,400
2	Njesia nr 2	221	770,920
3	Njesia nr 3	78	288,500
4	Njesia nr 4	256	1,034,520
5	Njesia nr 5	303	1,131,680
6	Njesia nr 6	400	1,597,500
7	Njesia nr 7	132	526,820
8	Njesia nr 8	145	545,300
9	Njesia nr 9	235	796,660
10	Njesia nr 10	64	213,960
11	Njesia 11	203	905,780
12	Nj Petrele	95	513,340
13	Njesia Farke	129	651,320
14	Njesia Dajt	183	947,060
15	Njesia Zall-Bastar	504	2,594,420
16	Njesia Berzhite	274	1,352,840
17	Njesia Krrabe	130	629,920

18	Njesia Baldushk	234	1,180,980
19	Njesia Shengjergj	279	1,316,980
20	Njesia Vaqarr	163	892,880
21	Njesia Kashar	424	1,976,760
22	Njesia Peze	58	281,600
23	Njesia Ndroq	164	822,700
24	Njesia Zall-Herr	180	930,860
	<b>TOTALI</b>	<b>5,086</b>	<b>22,758,700</b>

### ***Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale***

Sipas të njëjtit burim, për vitin 2017 numri i personave të dhunuar në ndihmë ekonomike është 69, ku përfshihen UMM dhe UM.

### **Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020**

***Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve per vitet 2018 dhe 2019.***

#### **Gjetjet kryesore të monitorimit të Strategjisë në bashkinë e Tiranës**

Në bazë të monitorimit të punës së Bashkisë Tiranë për përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, për vitin 2017 gjetjet kryesore për këtë bashki janë si më poshtë:

- Mekanizmi i referimit në Bashkinë Tiranë ka funksionuar mirë dhe ka trajtuar sukseshëm 95 raste gjatë vitit 2017.
- Bashkia e Tiranë ka pasur një bashkëpunim të mirë me policinë, ç’ka vlen të theksohet edhe si model për t’u ndjekur nga bashkitë e tjera ku shpesh është identifikuar si sfidë në koordinimin dhe bashkëpunimin për adresimin e rasteve të dhunës ndaj grave.
- Bashkia e Tiranës ka alokuar në buxhetin e vitit 2017 vetëm pagën e Nëpunëses së Barazisë Gjinore (NBGj) kundër dhunës me bazë gjinore në masën 918.800 leke. Asnjë fond tjetër për aktivitete kundër dhunës në familje nuk është venë në dispozicion.
- Bashkia e Tiranës ka pasur përgjatë vitit 2017 angazhim aktiv në përmbushjen e objektivit 3.1 për rritjen e ndërgjegjësimit për mos pranimin dhe mos tolerimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore janë aktorë të rëndësishëm dhe duhet të mbështeten aktivisht nga bashkia. Përgjatë vitit 2017 ka pasur koordinim të rëndësishëm ndërmjet disa organizatave dhe bashkisë. Mbështetja me fonde të bashkisë të një prej këtyre organizatave, e cila gjatë vitit 2017 është parashikuar të shtonte në buxhetin për vitin 2018, është një hap pozitiv

drejt ndarjes së përgjegjësive dhe përdorimit efikas të burimeve financiare për shfrytëzimin e ekspertizës dhe eksperiencës së shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve dhe përmbushjen e objektivave të strategjisë kombëtare për barazinë gjinore.

- Sikurse në bashkitë e tjera të monitoruara bashkëpunimi me zyrën e përmbartimit dhe prokurorinë është ende problematik pasi këto të fundit nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e grupit Teknik Ndërdisciplinar dhe ka pak komunikim e bashkëpunim në referimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Duhet lehtësuar procesi i raportimit të Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga ana e Gjykatës pasi procesi aktual e shmang bashkinë e cila i merr me vonesë të dhënat.
- Në Bashkinë e Tiranës mungon një strehëz emergjence e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të referuara që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të referimit.
- Bashkia e Tiranës duhet të lehtësojë procedurat dhe të shkurtojë kohën e nevojshme për marrjen e bonusit të qerasë për viktimat e dhunës në familje, pasi procedurat aktuale marrin kohë dhe shpesh pengojnë ofrimin e shërbimit për këto viktime.
- Sikurse edhe për bashki të tjera të monitoruara paraqitet nevoja e adresimit të mundësive rehabilituese për dhunuesit dhe rritjen e rolit të bashkisë dhe institucioneve të tjera pjesëmarrëse në mekanizmin e referimit për ofrimin e këtij shërbimi.

## Të dhëna statistikore

Tirana si qarku më i madh i vendit përjeton edhe nivelin më të lartë të raportuar të dhunës në familje. Sipas të dhënave të INSTAT, për vitin 2017 rreth 35.8% e të gjithë raportimeve të dhunës në familje gjenden gjeografikisht në zonën e Tiranës duke u renditur kështu e para në të 12 qarqet e Shqipërisë. Ky nivel është mjaft i lartë, veçanërisht krahasuar me Durrësin që renditet i dyti me 13.9% të rasteve të raportuara. Më tej, norma e raportimit të dhunës në familje në Tiranë është 26.3 raportime për 10,000 banorë, duke u renditur kështu e treta pas Durrësit dhe Vlorës. Norma e raportimit të dhunës në familje për Tiranën në vitin 2017 ishte më e lartë se mesatarja kombëtare prej 22.7 raportime për 10,000 banorë.<sup>1</sup>

Përgjatë vitit 2017 Gjykata e Tiranës ka regjistruar 414 çështje të reja dhe të mbartura për gjykim sa i përket nenit 130 të dhunës në familje. Për shumicën dërrmuese të këtyre çështjeve është marrë vendim fajësie.<sup>2</sup> Gjatë vitit kalendarik 2017 pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për çështjet civile janë paraqitur 266 kërkesa për Lëshim Urdhër Mbrojtje, nga të cilat 13 janë çështje të mbartura, 248 janë kërkesa të reja dhe 5 të ardhura pas prishjes. Sipas Gjykatës për çështjet civile, 66 prej këtyre çështjeve u pranuan, 174 u pushuan, 14 janë rrëzuar, 254 kanë përfunduar dhe 12 ishin të papërfunduara. Për të njëjtin vit në lidhje Lëshim Urdhër Mbrojtje të Menjëhershme, janë paraqitur pranë Gjykatës së Tiranës 767 kërkesa, nga të cilat 22 janë çështje të mbartura, 741 janë kërkesa të reja dhe 4 të ardhura pas prishjes. Sipas Gjykatës së për çështjet civile, 206 prej këtyre çështjeve janë pranuar, nuk ka asnjë rast pajtimi mes palësh, 506 janë pushuar, 27 janë rrëzuar, 739 kanë

<sup>1</sup>Instat. 2018. Burra dhe Gra 2018. Online: <http://ëëë.instat.gov.al/al/rreth-nesh/aktivitetet/promovimi-i-aktiviteteve-statistikore/burra-dhe-gra-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2018/>

<sup>2</sup> <http://ëëë.gjykatatirana.gov.al/Evidencat>

përfunduar dhe 28 ishin të papërfunduara. Përgjatë vitit 2017 pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për çështjet penale, janë ndjekur gjithsej 414 çështje për Dhunë në Familje sipas neneve 130/a/1; 130/a/2; 130/a/3; 130/a/4. 109 nga këto çështje ishin të mbartura, 304 çështje të reja. Në total me vendim fajësie për vitin 2017 ishin 337 çështje.

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Tiranë ka në përbërjen e saj 6 komisariate të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, specifikisht Komisarati nr. 1, nr.2, nr.3, nr.4, nr. 5 dhe nr.6. Të gjitha të dhënat mbledhen e më pas përpunohen në Drejtorinë vendore të Policisë së qarkut Tiranë. Përgjatë vitit kalendarik 2017 pranë këtyre komisariateve janë plotësuar gjithsej 778 Kërkesë-Padi për UMM/UM, 47 prej të cilave janë shkelur. Janë evidentuar gjithsej 522 raste të Dhunës në Familje sipas nenit 130/a. Ftkeqësisht 5 gra e vajza janë vrarë në bashkinë Tiranë për shkak të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Rastet e evedentuara nga raportimet kanë qenë 1508 në vitin 2017.

**Tabela 2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Tiranë**

Dhuna në familje	Kom.nr.1	Kom.nr.2	Kom. Nr.3	Kom.nr.4	Kom.nr.5	Kom.nr.6	Total
Raste te evidentuar	236	176	245	364	225	262	1508
Vrasje raste	2	0	0	0	3	0	5
Viktima	2	0	0	0	3	0	5
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	109	100	126	188	91	164	778
Shkelje U.Mbrojtjes	9	1	7	10	8	12	47
Vepër penale- Neni 130/a	98	47	87	132	93	65	522
Autorë të arrestuar	49	18	34	39	43	23	206
Autorë të ndaluar	4	3	4	10	2	5	28
Autorë të shpallur në kërkim	7	3	2	7	6	5	30
Autorë në gjendje të lirë	40	24	52	85	47	38	286
Autorë të vetvlarë	0	0	0	0	1	0	1

**Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit**

Rastet e suksesshme të referuara dhe trajtuara nga mekanizmi i referimit për vitin 2017 kanë qenë 95.

Sipas të dhënave nga Sektori i Përfshirjes Sociale & Barazisë Gjinore, përgjatë vitit 2017, janë njësitë administrative 4 dhe 6, të cilat janë identifikuar me numrin më të lartë të dhunës në familje, përkatësisht:

- Njësia Administrative Nr. 4: 102 raste UMM/UM
- Njësia Administrative Nr. 6: 88 raste UMM/Um

Raste të shumta dhune gjatë 2017-ës janë evidentuar edhe në Njësinë Administrative nr. 1 me 56 raste UMM/UM) dhe atë nr. 11 me 50 raste UMM/UM. Përsa i përket njësite të reja administrative (ish komunave), problematika më e madhe gjatë vitit 2017 është evidentuar në:

- Njësia Administrative Kashar: 10 UMM/UM
- Njësia Administrative Farke: 10 UMM/UM
- Njësia Administrative Vaqarr: 4 UMM/UM

Raportimet e dhunës me bazë gjinore në rajonet e policisë së Bashkisë Tiranë, pasqyrohen sipas tabelave vijuese.

**Tabela 3. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në (stacionet )rajonet e policisë së Bashkisë Tiranë**

<b>Drejtoria Vendore Policisë së Qarkut Tiranë</b>	<b>Kërkesë padi për UM/UMM</b>
Komisariati policisë nr. 1	109
Komisariati i policisë nr. 2	96
Komisariati i policisë nr. 3	127
Komisariati i policisë nr. 4	189
Komisariati i policisë nr. 6	162
<b>Total</b>	<b>683 Raste</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë*

<b>Drejtoria Vendore Policisë së Qarkut Tiranë</b>	<b>Raste DHF sipas nenit 130/a</b>
Komisariati policisë nr. 1	96
Komisariati i policisë nr. 2	46
Komisariati i policisë nr. 3	90
Komisariati i policisë nr. 4	126
Komisariati i policisë nr. 6	61
<b>Total</b>	<b>419 Raste</b>

*Burimi: Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë*

## Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

### Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Përgjatë vitit 2017 Bashkia e Tiranës ka zhvilluar një sërë aktivitete ndërgjegjësuese për nxitjen e mos pranimit dhe tolerimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Për këtë arsye vetë bashkia ka organizuar rreth **20 aktivitete** dhe organizatat e shoqërisë civile kanë qenë gjithashtu aktive në rritjen e ndërgjegjësit të banorëve të bashkisë. Kjo ka rezultuar në pjesëmarrjen e rreth 1000 personave në aktivitetet e ndryshme të organizuara për vitin 2017. Në këtë kuadër, sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në bashkëpunim me institucionet e linjës organizon fushata ndërgjegjësuese për promovimin e barazisë gjinore dhe uljen e dhunës me bazë gjinore dhe në familje. Fushatat si “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës Gjinore dhe në Familje”, “Dita Portokalli” “Dita Ndërkombëtare e Gruas” janë trajtuar nga ky sektor si pikat kryesore të përmbushjes së objektivit 3.1 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Në kuadër të fushatës së 16 ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, bashkia e Tiranës organzoi

ceremoninë e ndriçimit me ngjyrë portokalli të Kullës së Sahatit të Tiranës, në 7 Dhjetor 2017, me mbështjetjen e UN Women. Për shkak të zgjerimit të bashkisë Tiranë pas reformës administrative vëmendja është përqendruar edhe në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese në njësitë e reja administrative. Më specifikisht janë organizuar takime:

- Me komunitetin e Njesisë Administrative Shengjergj, në datën 5 Maj 2017
- Me komunitetin e Njesisë Administrative Zall Herr, në datën 11 Maj 2017
- Me komunitetin e Njesisë Administrative Zall Bastar, në datën 5 Korrik 2017

Në kuadër të përmbushjes së objektivit 3.1 bashkia e Tiranës ka bashkëpunuar me policinë, veçanërisht gjatë ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore duke organizuar takime të ndryshme në shkollat e Tiranës. Takimet ndërgjegjësuese janë zhvilluar në 3 shkolla të Tiranës:

- Shkolla e mesme “Çajupi”, datë 30 Nëntor
- Shkolla e mesme “Myslym Keta”, datë 01 Dhjetor
- Shkolla e mesme “Aleks Buda”, datë 04 Dhjetor

Gjithashtu, janë realizuar shfaqje filmi rreth dhunës për nxënësit nga shkolla e mesme “Petro Nini Luarasi” në datën 07 Dhjetor 2017. Përveç bashkëpunimit me policinë, Bashkia e Tiranës ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese edhe në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile. Së bashku me Strehëzën për Gra dhe Vajza janë zhvilluar trajnime me profesionistët mbi përdorimin e librit “Tullumbacja e lumturisë” për ngritjen kapaciteteve të punonjësve arsimorë në parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e fëmijëve të abuzuar, në 2 Qendra Sociale të Bashkisë Tiranë si më poshtë:

- Qendra Multidisiplinare, datë 26 Maj 2017, dhe
- Qendrën Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, datë 30 Qershor 2017.

Së bashku me QSHK “Sot për të Ardhmen” janë zhvilluar një sërë aktiviteteve si më poshtë:

- Me përfitues të Qendrës Sociale "Të qëndrojmë së bashku", Kombinat, datë 14-15 Shtator (Moduli 1: Dhuna me baze gjinore dhe në familje (faktoret dhe pasojat). Sherbimet e ngritura për të mbijetuarat e dhunës nga Bashkia Tiranë dhe Moduli 2: Marrëdhëniet brenda familjes: Zgjidhja e konflikteve dhe komunikimi pozitiv).
- Me përfitues të Qendrës Sociale Multidisiplinare, datë 22.09.2017. (Moduli: Dhuna ndaj të moshuarve)

*Gjithashtu, në 8 Mars 2017 Bashkia e Tiranës nënshkroi Kartën Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.*

Në kuadër të Kartës Evropiane, gjatë vitit 2017 filloi dhe hartimi i Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020.

***Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre***

Data	Vendi	Tema	Organizua nga:



8.3.2017		<i>Nënshkrimi i Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore</i>	Bashkia Tiranë
5.5.2017	Njësia Administrative Shengjergj	Takime Ndërgjegjësuese në Njësiti e Reja Administrate	Bashkia Tiranë
11.5.2017	Njësia Administrative Zall Herr	Takime Ndërgjegjësuese në Njësiti e Reja Administrate	Bashkia Tiranë
26.5.2017	Qendra Multidisiplinare	Takime Ndërgjegjësuese në bashkëpunim me Strehëzën për Gra dhe Vajza	Bashkia Tiranë
5.7.2017	Njësia Administrative Zall Bastar	Takime Ndërgjegjësuese në Njësiti e Reja Administrate	Bashkia Tiranë
30.7.2017	Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët	Takime Ndërgjegjësuese në bashkëpunim me Strehëzën për Gra dhe Vajza	Bashkia Tiranë
14.9.2017	Qendra Sociale "Të qëndrojmë së bashku", Kombinatat	Sherbimet e ngritura për të mbijetuarat e dhunës nga Bashkia Tiranë	Bashkia Tiranë
15.9.2017	Qendra Sociale "Të qëndrojmë së bashku", Kombinatat	Zgjidhja e konflikteve dhe komunikimi pozitiv	Bashkia Tiranë
22.9.2017	Qendra Sociale Multidisiplinare	Dhuna ndaj të moshuarve	Bashkia Tiranë
30.11.2017	Shkolla e Mesme „Çajupi“	Takime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me Policinë	Bashkia Tiranë
1.12.2017	Shkolla e Mesme „Myslym Keta“	Takime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me Policinë	Bashkia Tiranë
4.12.2017	Shkolla e Mesme „Aleksa Buda“	Takime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me Policinë	Bashkia Tiranë
7.12.2017	Kulla e Sahatit	Ceremonia e ndriçimit me ngjyrë portokalli	Bashkia Tiranë
7.12.2017	Shkolla e Mesme „Petro Nini Luarasi“	Shfaqje filmi rreth dhunës për nxënësit	Bashkia Tiranë
25.11.2017-10.12.2017		16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës Gjimore dhe në Familje	Bashkia Tiranë

**Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjimore dhe dhunës në familje.**

Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë hapash të mëtejshme për forcimin e mekanizmit të referimit. Për shembull, megjithëse paga e koordinatorës së dhunës ( 918800 lekë) përbën burimin kryesor të financimit të luftës kundër dhunës me bazë gjimore dhe dhunës në familje, në buxhetin

e Bashkisë Tiranë për vitin 2018 është parashikuar edhe financimi i Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza në masën 474,000 Lekë, që përbën edhe zërin kryesor për adresimin e fenomenit.

Marrëveshja e Bashkëpunimit për ngritjen e Mekanizmit të Referimit në Bashkinë Tiranë u nënshkrua fillimisht më datë 28 Maj 2012. Aktualisht po hartohet një Marrëveshje e re Bashkëpunimi ku po merren parasysh komente dhe sugjerime nga të gjithë aktorët e Mekanizmit si dhe ku do të përfshihen 3 institucionet e reja si më poshtë:

- Linja e këshillimit për Gra dhe Vajza;
- Linja e këshillimit për Burra dhe Djem;
- Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci.
- QZHK “Sot për të ardhmen”

Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 në rolin e koordinatorit të Mekanizmit të Referimit, ka organizuar gjashtë mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar (GTN). Përkatesisht në datat 23 Janar, 22 Shkurt, 30 Mars, 29 Qershor, 20 Tetor dhe 23 Nentor 2017. Rastet e suksesshme të referuara dhe trajtuara nga mekanizmi i referimit për vitin 2017 kanë qenë 95.

Në mbledhjet e GTN-së kanë marrë pjesë përfaqësuesit e institucioneve pjesë të Mekanizmit të Referimit, konkretisht:

- Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë,
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
- Prokuroria e Rrethit Tiranë,
- Zyra e Përmbartimit Tiranë,
- Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë,
- Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë,
- Spitali (QSUT) Tiranë,
- Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë,
- Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë,
- Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë,
- Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë,
- QZHK “Sot për të Ardhmen”.
- Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza dhe Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Grupi Teknik Ndërdisciplinar (GTN) marrin pjesë në procesin e vlerësimit të rastit dhe angazhohen për zgjidhjen e tij. Institucionet janë nxitur të jenë pjesëmarrëse aktive në menaxhimin e rasteve si dhe të koordinojnë punën me njëra-tjetrën në mënyrë që të mund t'u shërbejnë sa më mirë të mbijetuarve të dhunës në familje në radhë të parë, por edhe anëtarëve të tjerë të familjes të prekur nga dhuna, që shpesh kanë probleme të thella ekonomike-sociale. Me përjashtim të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, të gjitha institucionet e tjera marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e ETN-së ose në aktivitete të tjera të përbashkëta. Pavarësisht ngritjes së mekanizmit, përgjatë vitit 2017 nuk ka pasur trajnime të përbashkëta të anëtarëve të MKR, megjithëse kjo është identifikuar si domosdoshmëri për mirëfunksionimin e tij.

Përmes dokumentacionit të analizuar në kuadër të monitorimit vihet re një bashkëpunim i mirë dhe i vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile të cilat ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Për shembull, Organizata Sot për të Ardhmen, ka qenë pjesë e mekanizmit që në maj të vitit 2012, e cila administron Numrin e Gjelbër lokal pa pagesë 08009888. Ky numër ofron këshillim dhe ndihmë psikologjike për gratë dhe vajzat e dhunuara.

Rastet e mbështetura nëpërmjet Numrit të Gjelbër 08009888 gjatë vitit 2017 janë 545 telefonata në total të klasifikuara si më poshtë:

- 304 telefonata për këshillim (telefonata ku ofrohet këshillim psikologjik për viktimat e dhunës në familje)
- 189 telefonata për informacion (Telefonata ku kërkohet informacion mbi shërbimet e ofruara nga numri i gjelbër apo mbi çështje të tjera në lidhje me dhunën në familje)
- 50 telefonata për arsye “të tjera” (Në këtë kategori hyjnë ato telefonata qëllimi i të cilave nuk mund të përmbushet nga numri i gjelbër)
- 2 telefonata testuese (Në këtë kategori hyjnë telefonatat e heshtura etj)

Pozicioni i koordinatorës vendore për menaxhimin e mekanizmit të referimit është krijuar në vitin 2013 dhe funksionet e këtij pozicioni janë ushtruar që prej vitit 2013 nga i njëjti person, duke krijuar kështu vijueshmëri dhe mundësimin e krijimit të kujtesës institucionale për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Sistemi online i referimit të rasteve të dhunës aksesohet në mënyrë periodike, por jo çdo ditë për shkak edhe të detyrave të tjera me të cilat angazhohet koordinatori brenda drejtorisë që përfaqëson.

Për t’u theksuar në Bashkinë e Tiranës është niveli i bashkëpunimit me policinë, i cili ndryshe nga pjesa më e madhe e bashkive të monitoruara është i suksesshëm edhe për shkak të burimeve më të mëdha njerëzore pranë drejtorisë vendore të policisë Tiranë, ku 2 specialiste i përkushtohen çështjeve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së të miturve. Duket se ka komunikim të rregullt e të vazhdueshëm për referimin e rasteve të dhunës dhe koordinimin me komisariatet e ndryshme dhe specialistët e policisë së zones sipas rastit. Bashkëpunimi me shërbimet sociale dhe zyrën e punësimit gjithashtu theksohet si rast suksesi pasi ka komunikim të vazhdueshëm për adresimin e përbashkët të rasteve të dhunës si edhe këto të fundit janë mjaft aktive në mbledhjet e ekipit teknik ndërdisiplinar.

Problemet mbeten në bashkëpunimin me Prokurorinë dhe Zyrën e Përmbartimit. Sipas ligjit, kur një Urdhër Mbrojtjeje (UM) ose Urdhër i Menjëhershë Mbrojtjeje (UMM) vjen nga Gjykata, ai duhet të ekzekutohet menjëherë nga Përmbartimi, që rezulton të mos ketë dosjet e veta për rastin dhe nuk vepron, nëse viktimat e dhunës nuk shkon të regjistrohet vetë atje.

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 96, datë 28.09.2017 “Për miratimin dhe zbatimin e projektit ”Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes (II)” me fond total 7,700,000 Lek, ofron asistencë në formë granti nga 280,000 në 420,000 Lek për secilin plan-biznesi të zhvilluar me sukses dhe që priret të jetë i realizueshëm, duke mbështetur kryesisht gratë kryefamiljare, të dhunuara, gratë me aftësi të kufizuara si dhe gratë nga grupet e minoriteteve etnike.

Në Bashkinë e Tiranës mungon një strehëz emergjence e cila do të lehtësonte trajtimin e rasteve që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme për strehim dhe këshillim. Kjo paraqitet edhe si një nga nevojat më të rëndësishme të bashkisë në përforcimin e përmbushjes së objektivit 3.2 për forcimin e mekanizmit të referimit në nivel vendor.

Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”, i ndryshuar; udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2008 “Për Përmbajtjen e Bonusit të Strehimit” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 28.02.2013 për “Miratimin

e Sistemit të Pikëzimit për Programin e Subvencionimit të Familjeve që Përfitojnë Kredi të Lehtësuara nga Shteti, Sistemin e Pikëzimit për Programin e Banesave Sociale me Qira dhe Sistemin e Pikëzimit për Bonusin e Strehimit”, Bashkia Tiranë, u jep përparësi kërkesave për strehim social të viktimave të dhunës në familje. Megjithatë procedurat e aplikimit për Bonus Qiraje kërkon të paktën 2 muaj kohë deri sa të bëhet e mundur tërheqja e pagesës për muajin e parë nga përfituesja. Për këtë arsye, strehimi i viktimave të dhunës 2-3 muajt e parë mbetet sfidë për Bashkinë Tiranë.

**Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së sipas viteve në Bashkinë Tiranë**

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	
2015	
2016	
2017	6 (gjashtë)

**Burimi: Bashkia Tiranë**

Komiteti Drejtues është mbledhur vetëm një herë në 28 Maj 2012 kur është nënshkruar Marrëveshja e parë e Bashkëpunimit për ngritjen e Mekanizmit të Referimit.

**Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Tiranë**

Viti	Mbledhjet e KD
2014	
2015	
2016	
2017	Nuk ka pasur mbledhje

**Burimi: Burimi Bashkia Tiranë**

Pozicioni i koordinatorit vendor për bashkinë e Tiranës është krijuar në vitin 2012 dhe detyrat janë kryer nga i njëjti person që prej emërimit të saj si Specialiste e Lartë për Dhunën në Familje, ku luan edhe rolin e Koordinatorit Vendor. Prej vitit 2013 iu shtua detyra e Specialistes së Barazisë Gjinore dhe dhunës në familje. Rreth 90% të kohës koordinatori vendor ia kushton dhunës në familje, megjithatë ngarkesa me tre role të ndryshme përbën pengesë për performimin e të gjitha roleve dhe përgjegjësi për secilin prej pozicioneve që mbulohet nga ky person. Detyrat e koordinatorit vendor janë specifikuar edhe në Rregulloren e re të Bashkisë Tiranë. Kjo rregullore është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

**Tabela 7. Koordinatorit vendor kundër DhBGj në Bashkinë Tiranë**

Viti	Koordinatori Vendor kundër DhBGj
2014	Anjeza Bojaxhiu
2015	Anjeza Bojaxhiu
2016	Anjeza Bojaxhiu
2017	Anjeza Bojaxhiu

**Burimi: Bashkia Tiranë**

Koordinatorja Vendore e Dhunës në Bashkinë e Tiranës ka marrë pjesë në një sërë aktivitete për ndarjen e eksperiencave sa i përket mekanizmave të referimit si më poshtë:

1. Trajnimet “Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i sistemit on-line të rasteve të dhunës në familje, me koordinatorët e rinj vendorë të bashkive”, datë 27 shkurt dhe 13 mars 2017.
2. Konferencën me temë: “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore - kusht për mbrojtjen nga dhuna dhe respektimin e të drejtave ekonomike në familje” organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), datë 25 Prill 2017.
3. Webinarin për “Ndarje eksperiencash me Korenë rreth Sistemit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës me bazë gjinore”, organizuar nga UNDP Shqipëri, datë 15 Nëntor 2017.
4. Trajnimin “Mbi efektivitetin e funksionimit të Mekanizmit të Bashkërendimit të Punës për Referimin dhe Trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje, në nivel vendor. Arritje dhe Sfidat”, datë 18-19 dhjetor 2017.

GTN-ja e Bashkisë Tiranë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve sipas tabelës më poshtë:

**Tabela 8. GTN-ja e Bashkisë Tiranë**

<b>NR</b>	<b>INSTITUCIONI</b>	<b>PËRFAQËSUESI</b>	<b>POZICIONI</b>
1.	Bashkia Tiranë	Erion Veliaj Anjeza Bojaxhiu	Kryetar i Bashkisë Koordinatorë Vendore
2.	Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë	Kastriot Skënderaj Lindita Lushaku Elena Hasango	Drejtor Specialiste për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje
3.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Enkelejdi Hajro Alba Nikolla	Kryetare Përgjegjëse e Personelit dhe Marrëdhënieve me Publikun
4.	Prokuroria e Rrethit Riranë	Dritan Rreshka	Drejtues
5.	Zyra e Përmbarimit Tiranë	Enea Dyrmishi Dorina Saja	Kryetar Përmbaruese Gjyqësore
6.	Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë	Bledar Xhemali Amarildo Mekollari	Drejtor Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit
7.	Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë	Dritan Ulqinaku Rudina Basha	Drejtor Specialiste
8.	Spitali QSUT Tiranë	Enkelejdi Joti Antuela Tane	Drejtor Përgjegjëse e Sektorit Psiko-Social
9.	Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë	Manjola Kaçi Eleni Pistoli	Drejtore Specialiste
10.	Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë	Ajola Byzyka Edlir Tërpo	Drejtore Specialist
11.	Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë	Marisa Kaçori Vera Mborja	Drejtore Specialiste
12.	Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë	Edlira Haxhiymeri Marsela Allmuça	Drejtore Punonjëse Sociale

13.	Rrjeti i Qendrave Komunitare “Sot për të Ardhmen” Tiranë	Fabiola Laço Migena Ismailati	Drejtores Psikologe
14.	Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”	Afërdita Prroni Oltiana Andrea	Drejtores Ekzekutive Juriste

**Burimi: Bashkia Tiranë**

### **Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.**

Është e një rëndësie të veçantë që të evidentohet fakti që kopjet e UMM/UM nga Gjykata i dërgohen Njësive Administrative të cilat japin dhe Ndihmën Ekonomike sipas UM.

Gjykatës i janë bërë disa kërkesa ndër vite që të dergojë një kopje dhe pranë Koordinatorës Vendore në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale në mënyrë që rastet e dhunës të pasqyrohen në databazën REVALB në kohë reale, por kjo nuk është mundësuar.

Për këtë arsye dhe çdo fillim muaji të gjitha njësistë administrative të Bashkisë Tiranë dërgojnë pranë Koordinatorës Vendore UMM/UM e muajit parardhës.

Shërbimi i Provës bashkëpunon me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza që është pjesë e Mekanizmit të Referimit por nuk merr vetë pjesë e Mekanizmit të Referimit Tiranë.

Bashkia Tiranë ashtu si dhe bashkitë e tjera të Shqipërisë nuk ofrojnë shërbime për burrat dhunues. Këto shërbime ofrohne nga organizata të shoqërisë civile të cilat janë pjesë e mekanizmit të referimit në nivel vendor.

Në bashkinë e Tiranës e vetmja organizatë që punon me rehabilitimin e dhunuesve është Linja e Këshillimit të Burrave dhe Djemve (LKBD). Sipas LKBD-së të dhënat e mbledhura për vitin 2017 tregojnë se:

- Numri i dhunuesve të cileve i është ofruar shërbim rehabilitimi nga LKBD: 67 persona. Nga të cilët 75% e rasteve, dhunuesit kanë ushtruar dhunë fizike dhe 25% e rasteve, dhunuesit kanë ushtruar dhunë psikologjike, përndjekje, dhunë seksuale ose financiare.
- Numri i seancave në total: 577 seanca këshillimi
- Raste të referuara nga institucione të ndryshme: 53 raste
- Raste të vetë referuara: 14 raste
- Numri i dhunuesve të të cileve i është ofruar shërbim rehabilitimi nga LKBD të ndarë sipas moshave rezultojnë si vijon: 22 persona nën 36 vjeç, 28 persona midis 36 – 45 vjeç dhe 17 persona të moshës mbi 45 vjeç.
- Në 70% të rasteve viktimat është partnerja ose ish-partnerja dhe në 30% të rasteve viktimat janë prindërit, fëmijet, vëllezër/motra ose të afërm.

Shërbimet që këtyre dhunuesve u janë ofruar nga Linja e Këshillimit të Burrave dhe Djemve janë si më poshtë:

- Këshillim personal ballë për ballë: 67 raste me 577 sesione
- Këshillim me anë të telefonit: 7
- Informacione të kërkuara me anë të telefonit: 73
- Telefonata për vendosjen e kontaktit për këshillim: 11
- Vetëreferime: 14
- Referime nga insitucione te tjera: 53 të ndarë si vijon:
  - Shërbimi I Provës: 19
  - Drejtoria e Burgjeve: 32
  - OJF-të: 2

Tabela vijuese pasqyron të dhënat në numër të dhunuesve të cilët kanë përfunduar në Gjykatën e Tiranës për veprën penale të dhunës në familje, sipas neneve 130/a/1; 130/a/2; 130/a/3; 130/a/4

**Tabela 9. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Tiranë**

Vitet	Nr. i dhunuesve
2014	311
2015	389
2016	501
2017	414

**Burimi: Përpunim i Autorit nga faqja online e Gjykatës së Tiranës**

### **Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë**

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Tiranës më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Bazuar në numrin shumë të lartë të raportimeve në bashkinë Tiranë kërkohet urgjentisht bashkëpunim dhe ndërveprim me të gjithë aktorët e GTN-së. Trajnimi i tyre dhe qendrueshmëria e stafit përfaqësues të institucioneve në GTNëshët domosdoshmëri
- Cdo insitucion duhet të marrë pjesë në mbledhjet e GTN-së dhe të marrë përgjegjësi jo thjesht të marrë pjesë.
- Duhet lehtësuar procesi i raportimit të Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga ana e Gjykatës pasi procesi aktual e shmang bashkinë e cila i merr me shumë vonesë të dhënat.
- Në bashkinë e Tiranës mungon një strehëz emergjence e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të referuara që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të referimit.
- Bashkia e Tiranës duhet të lehtësojë procedurat dhe të shkurtojë kohën e nevojshme për marrjen e bonusit të qerasë për viktimat e dhunës në familje, pasi procedurat aktuale marrin kohë dhe shpesh pengojnë ofrimin e shërbimit për këto viktime.
- Sikurse edhe për bashki të tjera të monitoruara paraqitet nevoja e adresimit të mundësive rehabilituese për dhunuesit dhe rritjen e rolit të bashkisë dhe institucioneve të tjera pjesëmarrëse në mekanizmin e referimit për ofrimin e këtij shërbimi.
- Bashkia e Tiranës duhet të alokojë buxhet të mjaftueshëm për aktivitete dhe material ndërjegjësuere kundër dhunës në familje.
- Bashkia e Tiranës duhet të ofrojë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore.
- Bashkia e Tiranës duhet të ndërtojë një qendër emergjence sa më parë dhe ta mbështesë me mjete financiare dhe burime njerëzore.

- MKR-ja Tiranë duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimat, fëmijët por edhe dhunuesi.
- Roli i NBGj është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe funksionimin e mekanizmit të referimit, ndaj është e domosdoshme të rishikohet struktura aktuale e bashkisë për të siguruar burimet e duhura financiare dhe kohore që ky peron ti dedikohet vetëm çështjeve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe çështjeve të barazisë gjinore.
- NBGj duhet të organizojë takime dhe të informojë të gjithë anëtarët e MKR-së në rastet kur ata ndërrohen për shkak të detyrës apo ndonjë arsyeje tjetër.
- Gjatë mbledhjeve duhet të mbahen minutat dhe të përgatiten skemat e të dhënave për rastet konkrete. Rastet të ndiqen deri në krijimin e bindjes se janë jashtë rrezikut të dhunuesit.

## Aneksë

### Aneksi 1- Detyrat e koordinatorit për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje

Koordinatori është anëtar i rrjetit të bashkive të nëpunësve vendorë gjinorë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Koordinatori mban mardhënie të pandërprera me Përgjegjësin e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe lehtëson takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- Shërben si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata referimi, për të dhënë informacion për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;
- Asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhri shkelet;
- Harton dhe azhuron një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim etj.) dhe i hedh ato në sistemin elektronik REVALB ;
- Siguron që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;
- Përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në sistemin revalb.org i cili përbën edhe regjistrin elektronik për mbajtjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje.
- Ndan një herë në muaj raportet e përditësuar që gjeneron sistemi REVALB si dhe një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e ekipit multidisiplinor. Sipas rastit këto raporte mund të jenë të kodifikuara (emri i të mbijetuarës/it të mos jetë dukshëm). Për të arritur këtë duhet:
- Të koordinojë punën me secilin anëtar të ekipit ndërdisiplinor me qëllim që ky i fundit të përcjellë te koordinatori nëpërmjet formularit të mbledhjes së të dhënave, një herë në dy



javë, informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni I tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore, apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet;

- Organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve;
- Harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip, bashkëngjitur këtij vendimi, dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;
- Bazuar në të dhënat e sistemit REVALB paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues;

## **Aneksi 2- Detyrat e të gjithë anëtarëve që kanë nëshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit si pjestarë të Mekanizmit të Rreferimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore**

### **Bashkia e Tiranës ka për detyrë:**

- të luajë rol drejtues në konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e mekanizmit referues për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- të grumbullojë të dhëna të standartizuara dhe të disagreguara mbi dhunën në familje dhe t'ua shpërndajë ato palëve të duhura;
- të përforcojë zbatimin në nivel lokal të buxheteve të përcaktuara për ndihmën ligjore pa pagesë për viktimat e dhunës në familje;
- të angazhohet në ngritjen e strukturave të shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje;
- të instalojë linja telefonike rajonale pa pagesë për 24 orë, të cilat më pas krijojnë lidhjen me policinë, me njësitë e urgjencës mjekësore dhe me organizatat jofitimprurëse për të koordinuar veprimet përkatëse;
- të ngrejë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit, dhe të koordinojë përpjekjet me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat respektive;
- të identifikojë personat që do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji;
- të hartojë marrëveshjet e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve përkatëse dhe institucionet e tjera shtetërore;
- të përgatisë dhe paraqesë kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, apo për urdhër mbrojtjeje për të mitur;
- t'a informojë viktimën ose personin që e shoqëron atë mbi shërbimet ekzistuese sociale dhe ta shoqërojë atë për në qendrat e duhura, duke siguruar transportin nëse është e nevojshme.

- nëpërmjet Strukturës së Barazisë Gjimore të monitorojë ndjekjen e rasteve dhe të koordinojë ndërhyrjet midis aktorëve;
- të mbledhë anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisiplinar në mënyrë periodike për të adresuar nevojat e rasteve të dhunë në familje;
- të ofrojë lehtësira në përfitimin nga programet sociale të bashkisë për rastet e dhunës në familje;
- të informojë në mënyrë peiodike aktorët dhe bashkëpunorët mbi programet sociale që ofron bashkia dhe ndryshimet e tyre;
- Të përcaktojë kuota në kopshte dhe çerdhe për fëmijët të cilët vijnë nga situatat e dhunës në familje. Të lehtësoje procesin e regjistrimit/integritit të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe.

#### **Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka për detyrë:**

- të reagojë menjëherë ndaj të gjitha thirrjeve (njoftime telefonike apo thirrje institucionale) për dhunë në familje;
- t'i intervistojë viktimat të ndara nga autorët e dhunës dhe të tjerët, konform procedurave standarte të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- të mbledhë prova për incidentin, përmes fotove, intervistave me dëshmitarët dhe me anë të teknikave të tjera investigative; e të vendosë në dispozicion të palëve informacionin e mbledhur;
- të plotësojë dokumentimin e hollësive të rastit; sipas formularëve tip të policisë;
- të transportojë viktimën në një vend të sigurt ose ta largojë keqbërësin për të garantuar sigurinë e viktimës;
- të iniciojë koordinimin e Ekipit Teknik Ndërdisiplinar, nëse kontaktohet e para si dhe të marrë masa të menjëherëshme për të njoftuar antarët përgjegjës të reagimit të koordinuar (që veprojnë në nivel menaxhim rasti);
- t'a informojë viktimën dhe ta asistojë viktimën në plotësimin e kërkesës si dhe në depozitimin e dosjes për marrjen e një urdhri mbrojtjeje, si dhe ta referojë atë tek antarët e tjerë të mekanizmit, për shërbime të mëtejshme;
- të reagojë dhe të ndërhyjë në çdo rast konstatimi apo informimi të shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes në kohën e duhur, për të garantuar sigurinë e viktimave; të nisë menjëherë kontaktin me prokurorët për shkeljen e urdhrave të lartpërmendur;
- të plotësojë dhe të dërgojë dokumentacionin për çështjen penale kur është rasti për përgjegjësi penale;
- të vlerësojë nevojën për kujdes mjekësor e nevoja të tjera urgjente, si dhe të mundësojë transportimin e viktimës në qendrën spitalore përkatëse;
- të garantojë që i gjithë personeli i policisë të trajnohet për reagimin ndaj dhunës në familje, ku përfshihen: punonjësit, oficerët dhe të gjithë reaguesit, e për sa më sipër të vërë në dijeni Koordinatorin Vendore për nevojat që mund të kenë/apo mund të identifikojnë.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka për detyrë:**

- të orientojë viktimën në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen mbi procesin dhe të drejtën, në zbatim të kodeve dhe procedurave përkatëse;

- të dërgojë kopjet e vendimeve të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes pranë Zyrës së Shërbimeve Sociale, Komisariateve përkatëse të Policisë si dhe Zyrës Përmbaremore të vendit të ekzekutimit të Urdhrit.

#### **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka për detyrë:**

- të sigurojë një analizë të çështjeve ligjore të paraqitura;
- të përcaktojë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe ndjekjen efikase të rastit; të marrë pjesë në përpjekjen e përbashkët dhe të ndihmojë me zgjidhjen e çështjeve që ngrihen; të jetë e gatshme 24 orë në ditë për 7 ditët e javës për ndërhyrjen në rastet e shkeljes së urdhrave të mbrojtjes ose të rasteve të tjera më serioze të dhunës;
- të ofrojë ndihmë dhe këshillim ligjor për reagimin e koordinuar të komunitetit, gjë e cila do të përmirësojë llojet e rasteve që janë paraqitur;
- të ndihmojë viktimat me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje; të informojë viktimat për mënyrën e depozitimit të akuzave penale për dokumentacionin që nevojitet, si dhe për veprimet që ata duhet të kryejnë në vijim;
- të bashkëpunojë me aktorët e tjerë kryesisht me policinë për të bashkërenduar ndërhyrjet në rastet e çështjeve të dhunës në familje.

#### **Zyra Përmbaremore Tiranë ka për detyrë:**

- të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës në lidhje me urdhërat mbrojtës;
- të kërkojë ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të urdhrave apo në rast shkeljeje të tyre;
- të vendosë prioritete dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.

#### **Instituti i Mjekësisë Ligjore ka për detyrë:**

- të marrë masa për ekzamiminimin e menjëhershëm dhe sipas parametrave të kërkuara në rast të paraqitjes së rasteve të dhunës në familje;
- të vijojë me procedurat përkatëse për ekzaminimin mjeko-ligjor, duke iu dhënë prioritet rasteve të dhunës në familje;
- t'ju japë prioritet dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, gjendjes civile, etj.
- të bashkëpunojë dhe shkëmbejë informacion në mënyrë periodike me aktorët e mekanizmit.

#### **Autoriteti Shëndetësor Rajonal dhe Spitali (OSUT) Tiranë, kanë për detyrë:**

- të sigurojnë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës, duke vënë në dijeni Koordinatorin Vendore;
- t'ju vënë në dispozicion viktimave dokumentacionin mbi lëndimet dhe raportet e saktë gjykatave; duke respektuar parimin e konfidencialitetit;
- t'i ndjekin viktimat për nevojat e tyre shëndetësore dhe të sigurojnë shëndetin e tyre;
- të marrin pjesë në mekanizmin referues për të ofruar konsulencë mjekësore dhe perspektivë për zhvillimin e një reagimi të plotë për viktimat;

- të trajnojnë personelin tjetër mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, pa i bërë publik emrat e tyre.

#### **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë ka për detyrë:**

- të marrë pjesë në shqyrtimin dhe ndjekjen e rasteve;
- të mbështesë ndjekjen e rastit sidomos me referimet që mund të nevojiten në institucione rezidenciale apo qendrat pritëse;
- të asistojë në përgatitjen e dosjes përkatëse të rastit duke u koordinuar me qendrat që ofrojnë këto shërbime.

#### **Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës ka për detyrë:**

- të lehtësojë procesin e regjistrimit dhe integritit në shkolla të fëmijëve të cilët vijnë nga situatat e dhunës në familje;
- zhvillimin e kurrikulave; integritin në kurset ekzistuese; garantimin që çdo nxënës të njohë dhe të informohet për dinamikën, për incidentet, për ligjin dhe burimet lidhur me dhunën në familje;
- trajnimin e mësuesve në lidhje me identifikimin, reagimin, burimet dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje;
- raportimin e rasteve të identifikuar të dhunës në familje, tek Koordinatorja Vendore.
- kujdesjen për zbatimin e urdhërave mbrojtës, kur këto përcaktojnë detyrime për dhunuesin për të mos kontaktuar fëmijët apo për të mos iu afruar godinave të tyre arsimore (kopshte, shkolla, etj). Në rast të shkeljes së këtyre urdhërave mbrojtës, drejtuesi/ja i institucionit duhet të njoftojë menjëherë policinë dhe Koordinatorin Vendore.

#### **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ka për detyrë:**

- të shqyrtojë me prioritet dhe procedurë të përsheptuara, të gjitha rastet e dhunës në familje që referohen pranë saj nga sistemi i reagimit të koordinuar;
- të përfshijë dhe trajtojë me prioritet të gjitha rastet e viktimave të dhunës në familje të cilat referohen pranë saj, në programet për nxitjen e punësimit, ndërmjetësim për punësim dhe formim profesional;
- të marrë masa për referimin e këtyre viktimave në programe të caktuara të formimit profesional, në varësi të nevojave të tregut të punës dhe kurseve të formimit profesional që janë duke u zhvilluar;
- në rast identifikimi/konstatimi të një shtate të dhunës në familje të paraqitur pranë saj, të bëjë menjëherë informimin dhe referimin në antarët e sistemit të reagimit të koordinuar;
- të ndihmojë në sensibilizimin dhe informimin e komunitetit, si dhe mbi mbrojtjen dhe ndihmën që mund t'ju ofrohet viktimave të dhunës në familje;
- të identifikojë dhe adresojë nevojat për trajnimin e personelit veçanërisht në lidhje me komunikimin, krijimin e besimit si dhe informimin e referimin e rasteve të dhunës në familje.

#### **Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza Tiranë ka për detyrë:**

- të dëgjojë me kujdes problemin dhe njohjen e situatës në të cilën ndodhet viktimja;

- të ofrojë këshillim psikologjik për viktimën për të dhënë ndihmën e parë dhe për të mbështetur psikologjikisht dhe emocionalisht atë (viktimën) që të rifitojë kontrollin mbi situatën;
- të ofrojë këshillim ligjor për dhunë në familje, dhunë me bazë gjinore dhe dhunë seksuale;
- të kontaktojë me policinë ose shërbimet e strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore në rast se viktimë është në rrezik ose ka nevojë për strehim;
- të kryejë përpjekje për të referuar dhunuesin në shërbimin e rehabilitimit që ofrohet nga Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem;
- të ofrojë mbështetje të vazhdueshme ndaj viktimës së dhunës në familje;
- të mbështesë në rastet e krizave për të siguruar mbrojtje dhe përgjigje të menjëhershme për të mbijetuarën/in, duke vendosur lidhje me Mekanizmin Lokal të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje që ndodhet më pranë vendbanimit të tyre;
- të ofrojë informacion rreth të drejtave të viktimave dhe mbrojtjen që siguron legjislacioni në fuqi;
- të ofrojë informacion për shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore, të punësimit etj për rastet në nevojë.

#### **Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem Tiranë ka për detyrë:**

- Të ofrojë një shërbim të specializuar falas dhe profesional në rehabilitimin e dhunuesve që shkaktojnë dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore;
- Të ofrojë seanca këshillimi individuale dhe në grup me burrat dhe djemtë e dhunshëm si dhe referim në shërbimet të tjera të specializuara;
- Ne ofrojmë konfidencialitet të plotë për sa i përket çështjeve që diskutohen gjatë seancave;
- Të ofrojë mënyra dhe teknika në menaxhimin e zemërimit;
- Të ofrojë një linjë telefonike për burrat dhe djemtë në numrin (04) 236 3712;
- Të promovojë punë me djemtë e rinj në fushën e parandalimit kundër dhunës në familje.

#### **Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë ka për detyrë:**

- të ofrojë strehim dhe ushqim falas për një afat të përcaktuar sipas standarteve për gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës në familje, si edhe për fëmijët e tyre, bazuar edhe në vendimet për urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të dhëna nga Gjykata, si edhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj organizate;
- të ofrojë këshillim dhe mbështetje psiko-sociale falas për viktimat e dhunës në familje, si edhe referimin e tyre në shërbime të tjera të specializuara;
- të ofrojë ndjekje të vazhdueshme të rasteve edhe pas daljes nga strehëza, me qëllim sigurimin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre në jetën normale;
- të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me aktorët e mekanizimit për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve

#### **Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” ka për detyrë:**

- të ofrojë mbështetje për aftësimin për jetën dhe ndërmjetësimin për punësim të të mbijetuarave të dhunës duke synuar fuqizimin ekonomik dhe integrimin e tyre;
- të ofrojë edukim dhe ndërgjegjësim mbi dhunën në familje dhe barazinë gjinore me të rinjtë, vajzat dhe gratë, komunitetet në nevojë.

**Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” ka për detyrë:**

- adresimin e informacionit të marrë për rastet e dhunës tek ekipi ndërmultidisiplinar që merret me trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për viktimat e dhunës në familje bazuar në të gjitha rregullat dhe standardet përkatëse;
- të informojë viktimat mbi mjetet ligjore që ofron ligji për Dhunën në Familje;
- ofrimin e këshillimit dhe ndihmës ligjore falas;
- përfaqësimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të rasteve të dhunës në familje;
- përgatitjen e akteve ligjore për viktimat e dhunës në familje;
- të informojë dhe referojë viktimat e dhunës në familje tek shërbimet ekzistuese;
- të raportojë ndaj personave përgjegjës mbi detyrat dhe përgjegjësitë që ka marrë përsipër në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;
- të bashkëpunojë me Bashkinë Tiranë dhe institucionet publike dhe jo publike në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje;
- të bashkëpunojë me Bashkinë Tiranë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të planifikuara në kuadrin e aktivitetit ndërgjegjësues, sensibilizues dhe parandalues kundër dhunës në familje dhe diskriminimit.